# JETËSHKRIM

## ALBAN IRFAN TORO

## 1. TË DHËNAT PERSONALE

Nr. Personal i Kartës së Identitetit: [redacted]

Shtetësia : Shqiptar

Datëlindja: 9.3.1971

Vendlindja: Tiranë

Adresa: Rruga "Elbasanit" - Tiranë

Tel/Cel:

Adresa Elektronike : [redacted]@gmail.com

## 2. TË DHËNA PËR PËRVOJËN PROFESIONALE

*(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga veprimtaria aktuale profesionale)*

Periudha:

Janar 2025 e në vijim Avokat/ Shërbim Avokatisë rregulluar nga ligji 55/2018

Janar 2006 -2018 Avokat i punësuar dhe i vetpunësuar i rregjistruar me licensë nr.716 dhe Nipt K72316004E

Mars 2007 - Nëntor 2010 Avokat dhe Drejtor i Departamentit Juridik në Shoqërinë e Sigurimeve "Atlantik" sha

a) Avokati ka detyrimin ti siguroje çdo klienti që përfaqëson mbrojtje profesionale, të drejtë dhe efektive në funksion të realizimit me besnikëri të interesave të tij; b) i ofron çdo klienti shërbim ligjor të barabartë, duke i garantuar mbrojtje pa asnjë diskriminim të çdo forme, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi; c) vepron me profesionalizëm, besnikëri, ndershmëri dhe dinjitet, si dhe udhëhiqet nga interesat

e klientit, në respekt të legjislacionit në fuqi, Statutit të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, si dhe rregullave të Kodit Etik të Avokatit; ç) garanton mbrojtje ose përfaqësim transparent, në interesin më të mirë të klientit që përfaqëson, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesit; d) ofron shërbime ndaj personave përfituese të ndihmës juridike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti; dh) ofron shërbimin e avokatisë në çdo rast mbi bazën e një marrëveshjeje me shkrim të lidhur midis tij dhe klientit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil. Nëse klienti vendos të zgjidhë marrëveshjen në çdo fazë të zbatimit të saj, avokati është i detyruar ta respektojë vendimin e klientit dhe të kërkojë shpërblim për punën e kryer deri në momentin e zgjidhjes së marrëveshjes. Kur shpërblimi nuk caktohet me mirëkuptim midis palëve, çështja mund të zgjidhet në rrugë gjyqësore; e) detyrohet të kthejë çdo dokumentacion të siguruar nga klienti në funksion të përfaqësimit ose mbrojtjes me përfundimin e marrëveshjes ndërmjet avokatit dhe klientit; ë) deklaron pranë Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë çdo ndryshim të të dhënave personale të depozituara, ndryshime të tjera në lidhje me gjendjen gjyqësore, si dhe fillimin e ushtrimit të detyrave apo funksioneve publike ose private; f) merr masat e nevojshme në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë profesionale, sipas rregullave të përcaktuara në Statutin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë; g) raporton për çdo dyshim të lindur në lidhje me masat e vigjilencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; gj) informon klientin për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, kur e vlerëson të arsyeshme dhe në interes të klientit; h) informon viktimën e veprës penale, për të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria
Dhoma Kombëtare e Avokatisë si person fizik me numër NIPTI - K72616004E e seli me adresë në Rrugën "Ferit Xhajko".

Periudha: Në vitet 2016 – 2018 kam kontribuar në Shkollën e Mesme "Faik Konica" me nje cikël leksionesh në fushën e së drejtës në lëndën "Qytetari".

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Shkolla jopublike Faik Konica

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit : Rruga Ismail Qemali, pranë Liceut Artistik Tiranë

Periudha: Dhjetor 2018 – Korrik 2024 Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Kam qenë anëtar i përhershëm i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për pesë vjet e gjashtë muaj si edhe anëtar i shumë komisioneve të përkohëshme të krijuara nga Këshilli në funksion të ushtrimit të detyrës së tij Kushtetuese.
Një nga Komisionet e Përhershëm të Këshillit të Lartë Gjyqësore është edhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vendimet e së cilit kanë përfaqësuar numërin më të madh[1] të projekteve e më pas vendimarrjeve të Këshillit. Ai ka ushtruar rolin e vet, ndër të tjera, duke përgatitur procesin e përzgjedhjes emërimit, promovimit, transferimit, delegimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë mbi bazën e kualifikimit profesional dhe integritetit personal, edhe nëpërmjet kohëzgjatjes së ushtrimit të funksionit e sigurisë financiare, pavarësisë në vendimmarrje, si dhe garantimit të të drejtave vetjake të gjyqtarit. Cdo projekt vendim i paraqitur në lidhje me emërimin apo karrierën e gjyqtarëve ka qenë i bazuar në kritere objektive të përcaktuar nga ligji për statusin.
Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka patur në fokus ndjekjen e procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, transferimit përkohësisht të gjyqtarëve, ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, si dhe ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga drejtuesit e gjykatave në lidhje me delegimin e gjyqtarëve të ndryshëm për shqyrtimin e çështjeve të caktuara. Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar kërkesat e Shkollës së Magjistraturës për numrin e magjistratëve të rinj.
Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur akte të shumta nënligjore të cilat me pas janë miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si edhe shumë akte administrative me karakter individual.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, adresë në Godina "Poli i Drejtësisë", Rr. "Ana Komnena" Tiranë

Periudha : Janar 2003 – Janar 2006 Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Drejtor i Departamentit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun

Objekti i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është kompensimi i depozitave si edhe mbrojtja e interesave të depozituesve duke kontribuar në stabilitetin e sistemit bankar e financiar shqiptar.

Detyra ime konsistonte në sigurimin e kryerjes korrekte dhe në kohë të punëve në sektor; zbatimi i detyrave duke bërë organizimin dhe koordinimin respektiv ndërmjet zyrave; konsulent i Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm për veprimet e tyre nga

[1] Nga te dhënat e publikuara për muajt janar korrik 2024 KLGJ -ja ka marrë 483 vendime, nga të cilat 100 projekt vendime jane përpiluar nga ana ime në funksion te anëtarit të Komisionit te Zhvillimit te Karrierës. Ky raport ka mbizotëruar pothuajse që nga momenti i krijimit të Këshillit te Lartë Gjyqsore.

*Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vleërsim, pikëzim, renditjes së kandidaturës.*

pikëpamja ligjore; kontrolli dhe miratimi apo këshillimi për dokumenta të tilla si drafte, rregullore, kontrata, letra këshillimi, marrëveshje të shkruara nga sektorët e ndryshëm të Agjencisë; njoftimi i kontrollit të brendshëm për të kryer një investigim në lidhje me shkelje të udhëzimeve, neglizhence dhe abuzime mbi veprimtarinë e punëmarrësve në sektor; vëzhgimi i ecurisë së personelit të sektorit, vlerësimi i tij: mbikëqyrja e punës, trajnimi i personelit, hartimi i planeve mbështetëse dhe dhënia e opinioneve rreth kuadrit të të drejtave të personelit, drejtorisë dhe administratës së burimeve njerëzore; delegimi i kompetencave dhe përgjegjësive respektive personelit, duke bërë një ndarje punësh produktive dhe të mjaftueshme mes tyre; sigurimi i kushteve për krijimtarinë dhe motivimin e personelit; intervistimi, seleksionimi i personelit të sektorit dhe dhënia e opinioneve për Zyrën e Burimeve Njerëzore, rregullimi i akordimit të lejeve vjetore të personelit, sipas procedurave të pushimit vjetor të paguar dhe në mënyrë që të mos ketë probleme në veprimtarinë e sektorit; inspektimi i raporteve të përgatitura nga Kontrolli i Brendshëm dhe veprimi sipas tyre; informimi i sektorëve për ndryshimet në legjislacion, veçanërisht përsa i përket veprimtarisë bankare; kontrolli, korrigjimi dhe aprovimi i raporteve të hartuara në sektor; dhënia e aprovimit rreth subjekteve të tilla si ngritje në detyrë e personelit, pushimet vjetore, koha jashtë orarit dhe çdo e drejtë tjetër sipas rregulloreve të brendëshme të krijuara nga Këshilli Drejtues; ushtrimi i autoritetit për dhënien e udhëzimeve për përgjegjësit e zyrave dhe vartësit për çështje që lidhen me sektorin.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave me adresë në rrugën "Elbasanit", Pallati Edil Al – It, Nr 317 Tirane, 1023 telefon : 04 236 2989

Gusht 1995 – Janar 2003 Jurist në Departamentin Juridik në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës Kombëtare Tregtare sha.

Shkurt 1999 - Shkurt 2003 Pedagog me kohë të pjesshme në Fakultetin e Gazetarisë, Universiteti i Tiranës

Mars 1997 - Gusht 2000 Përfaqësues i Bankës Kombëtare Tregtare në Këshillin Drejtues të Bankës Italo-Shqiptare

Banka Kombëtare Tregtare përfaqëson një nga bankat më të vjetra në Shqipëri dhe aktivitetit i saj daton që nga data në 29 nëntor të vitit 1925 me krijimin e degës së parë në godinën historike në Durrës. Banka Kombëtare Tregtare sha është bashkim i Bankës Kombëtare dhe asaj Tregtare duke u bashkuar në një të vetme në janar të vitit 1993. Ajo u rregjistrua si shoqëri aksionere në vitin 1997.

Në kuadër të aktivitetit tim përpiloja nga pikpamja juridike të gjitha shkresat me përmbajtje në fushën juridike, redaktoja të gjitha kontratat e produkteve që kjo bankë ofronte për klientët e saj si kredi, depozita, instrumenta pagesash, etj apo konsulencë në privatizimin e bankave shtetërore, përfaqësim në gjykatë në të gjitha cështjet dhe konfliktet gjyqësore (civile, penale apo administrative), përfaqësim në Këshillin Drejtues të Bankës Italo – Shqiptare, ku Banka Kombëtare Tregtare zotëronte 40 për qind të

kapitalit themeltar të saj, akte rregullative në funksionimin e Shoqërisë Aksionere apo kryerjen e aktivitetit të saj.

Adrese: Rruga e Vilave, Lundër 1, 1045, Tiranë, Shqipëri ,Nr tel 4 22 66 288

## 3. ARSIMIMI, KUALIFIKIMET, TRAINIMET DHE TITUJT PROFESIONALË

### 3.1 ARSIMIMI

*(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga lloji më i fundit i arsimimit)*

Periudha : 1991 - 1995 Fakultetit i Drejtësisë,Universiteti iTiranës

Periudha : 1993 – 1994 Fakulteti i Drejtësisë Trento, Itali
Via "Giusepe Verdi", 53 Trento Itali

Diplomuar Jurist,

mesatarja mbi 9

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë,
Adrese: Rruga Milto Tutulani

### 3.3 TRAINIMET

*(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga lloji më i fundit i arsimimit)*

Takime me natyrë shkëmbim eksperience dhe bashkëpunimi me disa Këshilla të Lartë Gjyqësor Ndërkombëtare (Portugali-Kroaci)

Krediti dhe praktikat bankare.
Collateral Laë,
Legal Aspects of Bank Privatisation, Capital and Securities Market Investment,
Commercial Loan Documentat,
Performing Loans, Concessions and Project Finance for Infrastructure Development,
Financial Transaction for Laëyer - An Introduction organized by the International Monetary

### 3.4 TITUJ PROFESIONALË

Periudha : 19.04.1999 License profesionale numer 716.

Lloji i titullit/ fusha profesionale : Avokat (prane Dhomës së Avokatisë Tiranë)

Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin : Ministria e Drejtësisë

## 5. ZOTËRIMI I GJUHËVE TË HUAJA

| **Gjuha** | Anglisht | | |
|---|---|---|---|
| **Aftësitë** | **Të kuptuarit** | **Të folurit** | **Shkrimi** |
| **Niveli i Zotërimit** | I Lartë | I Lartë | I Lartë |

Periudha : 21 .10.1996

Dokumenti i zotërimit të gjuhës së huaj : Dëshmi – vlerësuar me notën 8

Emri dhe lloji i institucionit që e ka lëshuar : Univeristeti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Adresa dhe kontaktet e institucionit : Rruga Elbasanit

| **Gjuha** | Italiane | | |
|---|---|---|---|
| **Aftësitë** | **Të kuptuarit** | **Të folurit** | **Shkrimi** |
| **Niveli i Zotërimit** | I Lartë | I Lartë | I Lartë |

Periudha : 18. 6.1996

Dokumenti i zotërimit të gjuhës së huaj : Dëshmi – vlerësuar me notën 9

Emri dhe lloji i institucionit që e ka lëshuar : Univeristeti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Adresa dhe kontaktet e institucionit : Rruga Elbasanit

| Gjuha | Spanjisht | | |
|---|---|---|---|
| **Aftësitë** | **Të kuptuarit** | **Të folurit** | **Shkrimi** |
| **Niveli i Zotërimit** | I mesëm | I ulët | I ulët |

Dokumenti i zotërimit të gjuhës së huaj : Pa dëshmi